



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr. 80**

**15 maj**

**2013**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr. 129/2013 datë 25.4.2013	Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimet e kontratës së koncesionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit të Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të ndërmarrjeve..... 3415
Ligj nr. 131/2013 datë 29.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar ..... 3415
Ligj nr. 135/2013 datë 29.4.2013	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”..... 3419
Ligj nr. 136/2013 datë 29.4.2013	Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit)” dhe të dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995””, të ndryshuar.. 3422
Ligj nr. 137/2013 datë 29.4.2013	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar ..... 3423
Dekret nr.8163 datë 10.5.2013	Për emërimin e rektorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës..... 3429
Vendim i KM nr. 399, datë 8.5.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 1210, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Kuman, të qarkut të Fierit”. 3430

**LIGJ**  
**Nr. 129/2013**

**PËR RATIFIKIMIN E KONTRATËS PËR ZGJATJEN DHE PËRMIRËSIMET E  
KONTRATËS SË KONCESIONIT “PËR PRODHIMIN DHE SHPËRNDARJEN E  
KARTAVE TË IDENTITETIT DHE TË PASAPORTAVE ELEKTRONIKE” NDËRMJET  
MINISTRISË SË BRENDSHME TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE GRUPIMIT TË  
MORPHO DHE FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TË NDËRMARRJEVE**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet kontrata për zgjatjen dhe përmirësimet e kontratës së koncesionit “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Grupimit Morpho dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 25.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8147, datë 2.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 131/2013**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7829, DATË 1.6.1994 “PËR  
NOTERINË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:



## Neni 1

Në nenin 37, pas pikës 9 shtohen pikat 10 dhe 11 me këtë përmbajtje:

“10. Administron Regjistrin Kombëtar të Testamenteve, në të cilin regjistrohen testamentet e nënshkruara prej noterëve.

11. Administron Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë, në të cilin regjistrohen dëshmitë e trashëgimisë ligjore dhe testamentare.”.

## Neni 2

Në nenin 52, pas paragrafit të dytë shtohen paragrafët e tretë dhe të katërt me këtë përmbajtje:

“Noteri, pasi të ketë redaktuar testamentin, në përputhje me paragrafët e parë dhe të dytë të këtij neni, bën regjistrimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Noteri refuzon përpilimin e aktit nëse disponimet e trashëgimlënësit nuk respektojnë elementet e vlefshmërisë së testamentit, sipas Kodit Civil.”.

## Neni 3

Neni 53 ndryshohet si më poshtë:

### “Neni 53

#### **Kërkesa për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë**

Noteri, pasi vihet në dijeni zyrtarisht nëpërmjet një kërkesë të shkruar nga personat e interesuar:

- a) kontrollon kompetencën vendore të tij, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil;
- b) dërgon një kërkesë pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë, së cilës i bashkëlidh një kopje të kërkesës së personit të interesuar dhe një kopje të certifikatës së vdekjes së trashëgimlënësit.

Pas marrjes së kërkesës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 3 ditëve, kontrollon në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë nëse trashëgimlënësi ka lënë një testament dhe/ose është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore apo testamentare nga ndonjë noter tjetër.

Brenda 3 ditëve pas marrjes së përgjigjes nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, noteri:

- a) drejton personin e interesuar te noteri, i cili ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë ose pranë të cilit është redaktuar testamenti, nëse ka;
- b) procedon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore ose testamentare, në përputhje me parashikimet e Kodit Civil, dhe e regjistron atë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmive të Trashëgimisë.

Kur lëshon dëshminë e trashëgimisë testamentare, noteri kontrollon nëse disponimet me testament të testatorit janë të vlefshme, sipas parashikimeve të bëra në Kodin Civil.

Kur disponimi me testament është i pavlefshëm, noteri, me vendim të arsyetuar, deklaron pavlefshmërinë e testamentit dhe vijon me lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore. Në rast se deklarohen të pavlefshme vetëm disa nga disponimet e testamentit, dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet vetëm për atë pjesë të disponimeve të testamentit që deklarohen të pavlefshme.”.

#### Neni 4

Pas nenit 53 shtohen nenet 53/1, 53/2, 53/3, 53/4 dhe 53/5 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 53/1

##### **Dëshmia e trashëgimisë**

Dëshmia e trashëgimisë lëshohet nga noteri, në përputhje me rregullat e caktuara në Kodin Civil, si dhe në këtë ligj. Përveç elementeve që kanë lidhje me dëshminë e trashëgimisë, të parashikuara në nenin 49 të këtij ligji, dëshmia e trashëgimisë duhet të përmbajë edhe:

a) bazën ligjore dhe elementet, mbi të cilat noteri konsiderohet që ka kompetencë territoriale për të lëshuar dëshminë;

b) të dhënat e kërkuarit: emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, gjendja civile, shtetësia, numri i identitetit, adresa dhe marrëdhënia me trashëgimlënësin;

c) të dhënat e trashëgimlënësit: emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, gjendja civile, shtetësia, numri i identitetit, adresa në datën e vdekjes, data dhe vendi i vdekjes;

ç) të dhënat e trashëgimtarëve: emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, gjendja civile, shtetësia, numri i identitetit, adresa;

d) të dhëna mbi regjimin pasuror martesor të trashëgimlënësit;

dh) të dhëna mbi padenjësinë ose heqjen dorë nga trashëgimia, nëse ka;

e) të dhëna mbi legun dhe barrën, nëse ka;

ë) pjesët takuese të secilit prej trashëgimtarëve;

f) çdo të dhënë tjetër të kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

Noteri mban origjinalin e dëshmisë së trashëgimisë dhe i lëshon kërkuarit ose çdo personi, që ka një interes të ligjshëm, një ose disa kopje të dëshmisë së trashëgimisë, të njësuara me origjinalin.

Noteri shënon në një regjistër të posaçëm të dhënat e çdo personi, të cilit i ka lëshuar një kopje të dëshmisë së trashëgimisë.

##### Neni 53/2

##### **Ndreqja e gabimeve në dëshminë e trashëgimisë**

Noteri, kryesisht ose me kërkesën e çdo personi, që ka një interes të ligjshëm, mund të ndreqë në çdo kohë gabimet e bëra në shkrim, në caktimin e pjesëve takuese, apo ndonjë pasaktësi të dukshme të dëshmisë së trashëgimisë.

Noteri njofton menjëherë të gjithë personat, të cilëve, sipas nenit 53/1 të këtij ligji, u është lëshuar një kopje e njësuar e dëshmisë së trashëgimisë, për çdo ndreqje të gabimeve.

##### Neni 53/3

##### **Ndryshimi i dëshmisë së trashëgimisë**

Noteri, pasi regjistron heqjen dorë nga trashëgimia, kryesisht lëshon një dëshmi të re trashëgimie, të cilën ia njofton menjëherë të gjithë personave, të cilëve, sipas nenit 53/1 të këtij ligji, u është lëshuar një kopje e njësuar e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.

Në dëshminë e re të trashëgimisë, noteri pasqyron ndryshimet në rrethin e trashëgimtarëve, pjesët e tyre takuese, si dhe të dhënat mbi aktin e heqjes dorë nga trashëgimia.

Noteri, pas lëshimit të dëshmisë së re të trashëgimisë, bën shënimin përkatës në dëshminë fillestare të trashëgimisë dhe më pas e regjistron atë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë.



#### Neni 53/4

### **Revokimi i dëshmisë së trashëgimisë**

Kur, me vendim gjyqësor të formës së prerë, pranohet padia për pavlefshmërinë e testamentit, për pjesëtimin e trashëgimisë apo atë që rrjedh nga trashëgimia, dhe ky vendim sjell efekte mbi përmbajtjen e dëshmisë së trashëgimisë, noteri, brenda 3 ditëve nga marrja dijeni, revokon me vendim dëshminë fillestare të trashëgimisë dhe lëshon një dëshmi të re trashëgimie.

Dëshmia e re e trashëgimisë, ku pasqyrohen edhe arsyet e revokimit të dëshmisë fillestare të trashëgimisë, i njoftohet menjëherë të gjithë personave, të cilëve, sipas nenit 53/1 të këtij ligji, u është lëshuar një kopje e njëzuar e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.

Noteri, pas lëshimit të dëshmisë së re të trashëgimisë, e regjistron atë në Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë, së bashku me vendimin për revokimin e dëshmisë fillestare të trashëgimisë.

#### Neni 53/5

### **Ankimi në gjykatë**

Përveç padive të përcaktuara në nenin 46 të Kodit të Procedurës Civile, ndaj çdo veprimi ose vendimi të noterit për lëshimin, refuzimin e lëshimit, ndreqjen e gabimeve, ndryshimin apo revokimin e dëshmisë së trashëgimisë, mund të bëhet ankim në gjykatë, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

#### Neni 5

Pas nenit 70 shtohet neni 70/1 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 70/1

### **Regjistri Kombëtar i Testamenteve dhe Regjistri Kombëtar i Dëshmimeve të Trashëgimisë**

Pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë krijohet Regjistri Kombëtar i Testamenteve, në të cilin noterët duhet të regjistrojnë testamentet e nënshkuara pranë tyre dhe Regjistri Kombëtar i Dëshmimeve të Trashëgimisë, në të cilin noterët regjistrojnë dëshmitë e trashëgimisë ligjore apo testamentare.

Regjistri Kombëtar i Testamenteve dhe Regjistri Kombëtar i Dëshmimeve të Trashëgimisë administrohen nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Drejtësisë.

Rregullat e hollësishme për Regjistrin Kombëtar të Testamenteve dhe për Regjistrin Kombëtar të Dëshmimeve të Trashëgimisë miratohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.”.

#### Neni 6

### **Dispozitë kalimtare**

Të gjitha testamentet e nënshkuara pranë noterëve përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Testamenteve brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### Neni 7

### **Aktet nënligjore**

Ngarkohet Ministri i Drejtësisë që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të nenit 5.

Neni 8  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 shtator 2013.

Miraturar në datën 29.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8164, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ**  
**Nr. 135/2013**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 128, DATË 11.5.2009 “PËR  
TREGTINË ELEKTRONIKE”<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 128, datë 11.5.2009 “Për tregtinë elektronike”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 2 pika 2, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:  
“d) për çështjet që lidhen me të drejtat e pronësisë intelektuale dhe industriale.”.

**Neni 2**

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “d” shfuqizohet.

2. Pas shkronjës “f” shtohen shkronjat “g”, “gj”, “h”, “i” dhe “j” me këtë përmbajtje:

“g) “Fusha e koordinuar” janë rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për shërbimet e shoqërisë së informacionit dhe ofruesit e shërbimit, si dhe rregullat për krijimin e operimin e shërbimeve të shoqërisë së informacionit, pavarësisht nëse ato janë të natyrës së përgjithshme apo të projektuar specifikisht për to.

gj) “Regjistri i përjashtimeve” është regjistri që ofruesi i shërbimit mban për regjistrimin e personave, të cilët nuk kanë dëshirë të marrin komunikime tregtare të pakërkua.

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar plotësisht me:

*Direktivën 2000/31/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 8 qershor 2000 “Mbi disa aspekte ligjore të shërbimeve të shoqërisë së informacionit, veçanërisht në tregtinë elektronike në tregun e brendshëm”, Numri CELEX: 32000L0031, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 178, datë 17.7.2000, faqe 1- 16.*



h) “Transmetimi i thjeshtë” (*mere conduit*) është shërbimi i ofruar nga një ofrues shërbimi për sigurimin e aksesit në rrjetin e komunikimit ose për sigurimin e shërbimit të transmetimit të të dhënave.

i) “*Caching*” është ruajtja e përkohshme, automatike e të dhënave të ofruara nga përdoruesi, me qëllim transmetimin në mënyrë më të efektshme të informacionit dhe për aksesimin më të shpejtë të informacionit në rast ripërdorimi nga përdoruesi.

j) “*Hosting*” është shërbimi i ruajtjes së të dhënave nga ofruesi i shërbimit, ku të dhënat e ruajtura zgjidhen dhe ngarkohen nga marrësi i shërbimit.”.

### Neni 3

Në nenin 5 pika 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në shkronjën d, pas fjalës “besimit” shtohet fjala “etnisë”.
2. Në shkronjën “e”, fjalët “shëndetin e klientëve;” zëvendësohen me fjalët “shëndetin publik;”.

### Neni 4

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

#### **Ofrimi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit nga vendet anëtare të BE-së**

Ofrimi i shërbimeve të shoqërisë së informacionit nga një ofrues shërbimi, i themeluar në një vend anëtar të Bashkimit Europian, për arsye që i përkasin fushës së rregullimit të koordinuar, nuk kufizohet në Republikën e Shqipërisë.”.

### Neni 5

Në nenin 6, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Çdo person, fizik ose juridik, në Republikën e Shqipërisë është i lirë të ofrojë shërbime të shoqërisë së informacionit pa autorizim paraprak ose çdo kërkesë tjetër që ka efekt të njëjtë me të.”.

### Neni 6

Në nenin 9, pikat 1 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Komunikimet tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike ose me SMS lejohen vetëm me miratimin paraprak të marrësit të tyre.

3. Çdo ofrues i shërbimeve, që ofron komunikime tregtare të pakërkuara nëpërmjet postës elektronike, mban një regjistër përjashtimesh, ku regjistrohen personat, të cilët nuk kanë dëshirë të marrin komunikime tregtare të pakërkuara. Ofruesit e shërbimeve janë të detyruar të kontrollojnë rregullisht dhe të respektojnë regjistrin e përjashtimeve.”.

### Neni 7

Titulli i kreut V ndryshohet si më poshtë:

“PËRGJEGJËSITË E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE NDËRMJETËSE”

## Neni 8

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Transmetimi i thjeshtë (*mere conduit*)”.

2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur ofrimi i shërbimit të shoqërisë së informacionit konsiston në transmetimin në një rrjet komunikimi të informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit ose në ofrimin e aksesit në një rrjet komunikimi, ofruesi i shërbimit nuk është përgjegjës për informacionin e transmetuar nëse:

a) nuk inicion transmetimin;

b) nuk zgjedh ose modifikon përmbajtjen e informacionit të transmetuar;

c) nuk zgjedh marrësin e transmetimit.”.

3. Në fund të pikës 2 shtohen fjalët “për transmetim”.

## Neni 9

Në nenin 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“*Hosting*”.

2. Në pikën 1, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Kur një shërbim i shoqërisë së informacionit konsiston në ruajtjen e informacionit të siguruar nga marrësi i shërbimit, ofruesi i shërbimit të shoqërisë së informacionit nuk është përgjegjës për informacionin e ruajtur me kërkesën e marrësit të shërbimit, nëse ofruesi i shërbimit:”.

## Neni 10

Në nenin 21 bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

“Autoritetet zbatuese”.

2. Pika 1 shfuqizohet.

3. Në pikën 2, fjalët “për mbrojtjen e konsumatorit” hiqen.

## Neni 11

Pas nenit 21 shtohet neni 21/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 21/1

### **Pikat e kontaktit dhe kooperimi**

1. Autoritetet zbatuese bashkëpunojnë për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj. Autoritetet zbatuese, brenda 90 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, përcaktojnë pikat e kontaktit për bashkëpunimin me shtetet anëtare dhe Komisionin e Bashkimit European dhe ku ofruesit e marrësit e shërbimeve të shoqërisë së informacionit:

a) sigurojnë informacion të përgjithshëm mbi të drejtat dhe detyrimet kontraktore, mbi ankesat dhe mekanizmat e dëmshpërblimit në dispozicion në rast mosmarrëveshjeje, si dhe aspekte praktike të përdorura në këto mekanizma, sipas legjislacionit në fuqi;

b) sigurojnë informacionin për autoritetet, ose organizatat kompetente që ofrojnë informacion shtesë apo asistencë praktike, sipas legjislacionit në fuqi.





2. Autoritetet zbatuese sigurojnë që pikat e kontaktit janë të arritshme në rrugë elektronike.”.

#### Neni 12

Në nenin 22 pika 1, pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:  
“e) për mosrespektim të nenit 9 për komunikimet tregtare të pakërkuara.”.

#### Neni 13

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

#### “Neni 25/1

Neni 5/1 hyn në fuqi në datën e aderimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European.”.

#### Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8168, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

### LIGJ

#### Nr. 136/2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7918, DATË 13.4.1995 “PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR. 1030, DATË 23.2.1995 “PËR EMETIMIN DHE SHPËRNDARJEN E BONOVE TË PRIVATIZIMIT (LEKË TË PRIVATIZIMIT)” DHE TË DEKRETIT NR. 1049, DATË 27.3.1995 “PËR DISA PLOTËSIME NË DEKRETIN NR. 1030, DATË 23.2.1995””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

#### VENDOSI:

#### Neni 1

Fjalja e fundit e nenit 3 të ligjit nr. 7918, datë 13.4.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë të privatizimit)” dhe të dekretit nr. 1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23.2.1995””, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë:

“Afati i përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit është deri më 31.12.2014.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8169, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**LIGJ  
Nr. 137/2013**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 033, DATË 11.12.2008 “PËR  
LOJËRAT E FATIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 3  
Fusha e zbatimit**

Fusha e zbatimit të këtij ligji përfshin subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë sipas kategorive të lojërave të fatit, të parashikuara në nenin 5 të këtij ligji, subjektet, të cilat kanë detyrimin për t'u pajisur me leje për ushtrim lojërash promocionale të fatit, subjektet, të cilat importojnë dhe tregtojnë pajisje për lojëra fati dhe pjesë këmbimi të tyre, si dhe autoritetin e mbikëqyrjes e të kontrollit të tyre.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 5, pas fjalëve “kazino elektronike” shtohen fjalët “kazino elektronike në distancë”.

2. Pas pikës 30 shtohet pika 31 me këtë përmbajtje:

“31. “Kazino elektronike në distancë” do të thotë kazino elektronike, sipas përkufizimit të dhënë në pikën 21 të këtij neni, por që ushtron aktivitet me çdo mjet komunikimi elektronik në distancë, duke përfshirë teknologjinë e telefonisë së lëvizshme, si dhe internetin, por pa u kufizuar vetëm në to.”.



### Neni 3

Në nenin 5, pas pikës 7 shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:

“8. Kazinotë elektronike në distancë.”.

### Neni 4

Në nenin 7, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ndalohet ndërtimi/marrja me qira e mjediseve, me fushë veprimtarie lojëra fati, të ekspozuara pranë institucioneve fetare, arsimore e shëndetësore dhe institucioneve bankare. Brenda një periudhe 6-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji, subjektet, që ushtrojnë veprimtarinë pranë këtyre institucioneve, duhet të marrin masat për ndryshimin e vendndodhjes. Në rast se brenda kësaj periudhe subjektet nuk kanë ndryshuar vendndodhje, NJMLF-ja procedon me heqjen e lejes së ushtrimit të aktivitetit.”.

### Neni 5

Në nenin 8 pika 2 paragrafi i dytë, pas fjalëve “përrjashtuar shoqëritë e basteve sportive” shtohen fjalët “kazinotë elektronike në distancë”.

### Neni 6

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “kazino elektronike” shtohen fjalët “kazino elektronike në distancë”.

2. Në fillim të pikës 4, pas fjalëve “kazino elektronike” shtohen fjalët “kazino elektronike në distancë”.

3. Në shkronjën “b” të pikës 4, pas fjalëve “kazino elektronike” shtohet fjalët “kazino elektronike në distancë”.

### Neni 7

Në nenin 12 pika 4 shkronja “b”, në fund të fjalisë shtohen fjalët “si dhe kazino elektronike në distancë”.

### Neni 8

Në titullin e kreut IV shtohen fjalët “DHE KAZINO ELEKTRONIKE NË DISTANCË”.

### Neni 9

Në nenin 22 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “kazino elektronike” shtohen fjalët “dhe kazino elektronike në distancë”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Për ushtrimin e veprimtarisë në kazino elektronike, shoqëria duhet të ketë paguar shumën 1 000 000 (një milion) lekë pranë organit tatimor, ku është regjistruar subjekti juridik. Për ushtrimin e veprimtarisë në kazino elektronike në distancë, shoqëria duhet të ketë paguar shumën 5 000 000 (pesë milionë) lekë pranë organit tatimor, ku është regjistruar subjekti juridik. Pagesa 3424

bëhet një herë në vit, brenda muajit janar. Në rast se shoqëria që operon në kazino elektronike fillon veprimtarinë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit, pagesa bëhet e plotë, 1 000 000 (një milion) lekë. Në rast se shoqëria e fillon veprimtarinë në gjashtëmujorin e dytë të vitit, pagesa është 500 000 (pesëqind mijë) lekë. Në rast se shoqëria që operon në kazino elektronike në distancë fillon veprimtarinë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit, pagesa bëhet e plotë, 5 000 000 (pesë milionë) lekë. Në rast se shoqëria e fillon veprimtarinë në gjashtëmujorin e dytë të vitit, pagesa është 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.”.

#### Neni 10

Pas nenit 23 shtohen nenet 23/1 dhe 23/2 me këtë përmbajtje:

##### “Neni 23/1

##### **Kriteret e lejimit për zhvillimin e lojës “kazino elektronike në distancë”**

1. Organizatori i kazinosë elektronike në distancë zhvillon këtë aktivitet pas plotësimit të kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe pas marrjes së lejes përkatëse nga ana e NJMLF-së. Kriteret që duhet të plotësojë një shoqëri për organizimin dhe ushtrimin e lojërave të fatit në kazinonë elektronike janë si më poshtë:

- a) të jetë shoqëri anonime, me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku në objektin e veprimtarisë të pasqyrohet veprimtaria për lojëra fati, sipas llojit të lojës që kërkohet;
- b) të jetë e pajisur me NUIS;
- c) kapitali themeltar i shoqërisë të jetë jo më i vogël se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;
- ç) të vetëdeklarojë aksionarët e shoqërisë, ata që kontrollojnë paketën kryesore të aksioneve, si dhe të japë të dhëna për kapitalet dhe interesat e aksionarëve në shoqëri të tjera, të përbashkëta ose jo të përbashkëta;
- d) të deklarojë burime të mjaftueshme financiare për të organizuar lojëra fati në distancë;
- dh) të paraqesë rregulloren e lojës, e cila, detyrimisht, duhet të përmbajë:
  - i) emrin dhe selinë e organizuesit;
  - ii) emrin, përshkrimin dhe kohëzgjatjen e lojës së fatit;
  - iii) kushtet për pjesëmarrje në lojën e fatit;
  - iv) afatin e fundit për pjesëmarrje në lojë;
  - v) fondin e fitimit dhe llojin e fitimeve;
  - vi) mënyrën, procedurën e mbikëqyrjes dhe të tërheqjes, përkatësisht, mënyrën e verifikimit të fitimeve;
  - vii) mënyrën e publikimit të shumave të fondit fitues dhe të rezultateve të lojës;
  - viii) mënyrën dhe afatin e pagesës së fitimeve monetare;
  - ix) mënyrën e njohjes me rregullat e pjesëmarrësit në lojë;
  - x) procedurat, që përdoren në rastin e revokimit të tërheqjes;
  - xi) çdo dokument shtesë, të kërkuar nga NJMLF-ja;
- e) të paraqesë ekstraktin nga QKR-ja, ku të vërtetohet se shoqëria nuk është në proces falimentimi apo likuidimi, nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale apo shkeljeje administrative. Vërtetimi të jetë edhe për secilin aksionar të shoqërisë;
- ë) të bëjë pagesën për fondin e ngurtësimit për fituesit e lojës në shumën 200 000 000 lekë, përpara paraqitjes së dokumentacionit administrativo-ligjor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji;
- f) të paraqesë dokumentin e certifikimit të serverit, në përputhje me udhëzimin e Ministrit të Financave.



2. Përveç NUIS-it, kriteret e sipërpërmendura vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara brenda 3 muajve të fundit nga data e miratimit të tyre nga organet përgjegjëse shtetërore, si dhe duhet të jenë origjinale apo të noterizuara.

Neni 23/2

**Organizimi i kazinosë elektronike në distancë, në servera të dedikuar, të certifikuar, të njohur dhe të monitorueshëm nga NJMLF-ja.**

1. Organizatori i kazinosë elektronike në distancë duhet të instalojë server brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me një siguri të lartë, që të përputhet minimalisht me këto kërkesa:

a) zona qendrore ku mbahen serverat e ku përpunohen kuotat dhe informacionet e tjera duhet të jetë e pajisur me një sistem kontrolli, që të regjistrojë çdo person që hyn dhe del në këtë zonë, datën, orën dhe identifikimin e personit dhe ta ruajë regjistrimin për të paktën një periudhë 3-mujore;

b) zona duhet të ketë kamera, të tipit CCTV, ku të gjitha pajisjet e lidhura të jenë të dukshme, në mënyrë të qartë;

c) zona duhet të jetë e ruajtur gjatë të gjithë kohës;

ç) zona duhet të ketë një rrjet pajisjesh monitoruese që mund të kontrollohen nga NJMLF-ja ose inspektorët e saj.

Për kazinonë elektronike në distancë, i gjithë sistemi duhet të operojë mbi një server të dedikuar, autorizuar për administrimin e lojërave të kazinosë elektronike në distancë, të monitorueshëm nëpërmjet kredencialeve përkatëse të NJMLF-së. Ky server duhet të përmbushë të gjitha kushtet e nivelit të lartë të sigurisë, të sistemeve mbrojtëse, kundrejt ndërhyrjeve të rrezikshme nga elemente të rrezikshme për dëmtimin e të dhënave dhe daljen jashtë pune të këtyre serverave.

Kushtet, kriteret dhe specifikimet teknike, me të cilat do të operojnë organizatorët e kazinosë elektronike në distancë, përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Serverat për organizimin dhe realizimin e kazinosë elektronike në distancë mund të jenë vendosur brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në rast se serveri është i vendosur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, atëherë organizatori i kazinosë elektronike në distancë duhet të bëjë të mundur që të gjitha të dhënat/informacionet, sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrit të Financave, të bëhen të disponueshme/të aksesueshme në një server të dedikuar, të vendosur në Republikën e Shqipërisë ose në çdo juridiksion tjetër, të miratuar nga NJMLF-ja. Në çdo rast, këto të dhëna, që duhet të bëhen të disponueshme/të aksesueshme, përfshijnë të dhënat për lojtarët dhe aktivitetin e tyre në lojërat e zhvilluara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Administratori i kazinosë elektronike në distancë duhet:

a) të ofrojë të drejta hyrëse për përfaqësuesit e NJMLF-së dhe të strukturës përgjegjëse për lojtarët e fatit në zonën, ku janë vendosur pajisjet e kazinosë elektronike në distancë;

b) të marrë më parë miratimin paraprak nga struktura përgjegjëse për lojtarët e fatit, për çdo ndryshim material të sistemit, përpara se ky ndryshim të bëhet fakt nga organizatorët;

c) të sigurojë që vetëm personat e autorizuar prej tij do të kenë të drejta hyrëse në zonën, ku janë të vendosura pajisjet e kazinosë elektronike në distancë;

ç) të sigurojë që nuk do të ketë asnjë ndërhyrje në të dhënat e sistemit;

d) të regjistrojë, paraprakisht, çdo lojtar që do të marrë pjesë në lojë, për shumën të luajtura ose të fituara, si dhe të marrë të dhëna për identitetin e tyre;

dh) nuk duhet të pranojë nga lojtarët para *cash*, pra pagesat nga lojtarët në llogaritë elektronike që ata kanë me organizatorin duhet të kryhen vetëm nëpërmjet llogarive bankare, me kartë krediti a debiti, kartë të parapaguar nga portofoli elektronik ose çdo mjet tjetër pagese në

formë elektronike;

e) duhet t'i paguajë lojtarët fitues sa më shpejt të jetë e mundur, vetëm nga llogaria, ku janë depozituar pagesat dhe vetëm në llogarinë në emër të fituesit;

ë) nuk duhet të lejojë një person të marrë pjesë në lojë si lojtar, përveç rastit kur ky person është i regjistruar si lojtar dhe ka një llogari bankare *on-line* me organizatorin e kazinosë elektronike në distancë; të regjistrojë një person si lojtar vetëm nëse organizatori i kazinosë elektronike në distancë ka marrë prej këtij personi kërkesën/formularin e plotësuar për regjistrim. Ky formular duhet të përmbajë, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

i) moshën e lojtarit (në çdo rast lojtari duhet të jetë mbi 18 vjeç);

ii) numrin personal në kartën e identitetit të lojtarit;

iii) rezidencën e lojtarit;

iv) adresën e vlefshme *e-mail* të lojtarit.

Nëse organizatori merr dijeni që një person ka paraqitur informacion jo të vërtetë në lidhje me të dhënat e sipërpërmendura, ky i fundit nuk duhet ta regjistrojë këtë person ose të anulojë në mënyrë të menjëhershme regjistrimin e këtij personi.

Organizatori duhet të marrë në disponim dhe të ruajë në mënyrë elektronike kopje të dokumenteve të identifikimit të lojtarëve përpara se të transferojë çdo shumë nga llogaria bankare *on-line* e lojtarit me organizatorin të llogaria bankare e lojtarit;

f) duhet të mbajë në çdo kohë një listë të sigurt *on-line* me të gjithë lojtarët e regjistruar;

g) duhet të mbajë fondet e lojtarëve, të mbajtura në llogari *on-line*, të ndara nga fondet e tjera në pronësi të organizatorit. Kjo llogari të jetë në një institucion financiar të pranueshëm nga NJMLF-ja;

gj) duhet t'u ofrojë lojtarëve ndihmesë, të paktën nëpërmjet telefonit ose *e-mail*-it;

h) duhet t'i paraqesë NJMLF-së një raport mujor të shumave apo të pagesave të bëra nga klientët, si dhe të detyrimeve a pagesave të fituesve;

i) duhet të zbatojë procedura dhe masa siç mund të kërkohen nga NJMLF-ja.”.

#### Neni 11

Në nenin 42, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Në rast falimentimi apo heqjeje të lejes së ushtrimit të veprimtarisë, fondi i garancisë përdoret për shlyerjen e detyrimeve, sipas kësaj radhe:

a) pagesën e fitimeve të lojtarëve;

b) pagesën e detyrimeve që ka ndaj NJMLF-së;

c) pagesën e detyrimeve ndaj organeve tatimore.”.

#### Neni 12

Në nenin 43, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Organizatorit për zhvillim të lojërave të fatit i hiqet leja për zhvillim aktiviteti në rastet kur:

a) për të paktën 1 vit nuk ka zhvilluar aktivitet ose nuk ka bërë deklaratimet pranë organit tatimor dhe NJMLF-së;

b) kur ka pezulluar prej të paktën 1 viti aktivitetin pranë organeve përkatëse.”.

#### Neni 13

Në nenin 44, pas pikës 5.4 shtohet pika 5.5 me këtë përmbajtje:

“5.5. Për kazinotë elektronike në distancë, organizatori i kazinosë elektronike në distancë duhet të paguajë tatimin mujor mbi lojërat e fatit në masën 1,5 për qind mbi vëllimin e qarkullimit,



në bazë të arkëtimeve. Organizatori duhet t'u kthejë lojtarëve, në formën e fitimit, jo më pak se 90 për qind të shumës së vënë në lojë.”.

Neni 14

Në nenin 49, pika 3 shfuqizohet.

Neni 15

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 50

### **Bashkëpunimi i NJMLF-së me strukturat e tjera shtetërore**

1. Për zbatimin e detyrave ligjore, me kërkesën e saj, Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mbështetet nga strukturat e Policisë së Shtetit.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me strukturat në varësi të saj, për subjektet, që zhvillojnë veprimtari për lojëra fati, janë të detyruara të paraqesin të gjitha deklaratimet mujore, sipas sallave, të deklaruara nga subjektet dhe ndryshimet periodike, pranë NJMLF-së.

3. Hapja dhe mbyllja e sallave, ku zhvillohet aktivitet për lojëra fati, për efekte regjistrimi apo të tjera, bëhen nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit pas plotësimit të dokumentacionit përkatës dhe vetëm pas marrjes së miratimit me shkrim nga NJMLF-ja, sipas dispozitave të këtij ligji për hapjen/mbylljen e sallave të lojërave të fatit.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton rregullisht NJMLF-në, sa herë që zhdoganohen pajisje ose pjesë këmbimi që shërbejnë apo mund të shërbejnë për kryerjen dhe organizimin e lojërave të fatit”.

Neni 16

Pas nenit 50 shtohet neni 50/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 50/1

### **Procedurat e zhdoganimit të pajisjeve për lojëra fati dhe pjesëve të këmbimit të tyre**

1. Të gjitha mjetet e lojërave të fatit, të cilat do të përdoren për zhvillim aktiviteti në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të plotësojnë detyrimisht specifikimet teknike, siç janë parashikuar në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

2. Lejohen të importojnë mjete për lojëra fati, për qëllime tregtare, vetëm ata organizatorë, të cilët kanë marrë miratimin për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e lojërave të fatit nga organi përkatës.

3. Lejohen të importojnë pajisje për lojëra fati, me qëllime të ndryshme nga ato tregtare (si p.sh. për qëllime muzeale, ekspozimi, panairesh etj.), vetëm importuesit, të cilët kanë marrë miratimin paraprak nga NJMLF-ja. Në kërkesën e subjektit për miratim duhet të specifikohen, ndër të tjera, numri, tipi dhe qëllimi i përdorimit të mjeteve të lojërave të fatit. Ngarkohet me përgjegjësi importuesi dhe/ose përdoruesi nëse këto pajisje përdoren për qëllime të ndryshme nga ato të deklaruarat.

4. Të gjitha pjesët e këmbimit, elektronike apo mekanike, që shërbejnë apo mund të shërbejnë për riparimin apo zëvendësimin e pjesëve ekzistuese, u nënshtrohen të njëjtave procedura zhdoganimi si mjetet e lojërave të fatit.

5. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për përcaktimin e procedurave të zhdoganimit të pajisjeve për lojëra fati dhe pjesëve të këmbimit të tyre, si dhe mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet NJMLF-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.”.

Neni 17

Neni 51 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 51  
**Masat shtrënguese**

Kur Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit vëren shkelje të detyrimeve ndaj NJMLF-së, të parashikuara në këtë ligj nga subjektet e licencuara për ushtrim të aktivitetit për lojëra fati, 30 ditë pas datës së dërgimit të njoftimit subjektit përkatës, merr masat e mëposhtme shtrënguese, si më poshtë:

- a) pezullimin për një periudhë 30-ditore të veprimtarisë. Pezullimi nuk e ndalon pagesën e detyrimeve tatimore të mbledhura apo shlyerjen e detyrimeve të tjera të organizatorit;
- b) bllokimin e llogarive bankare deri në shlyerjen e detyrimit ligjor, për të cilin është marrë masa e pezullimit të veprimtarisë;
- c) konfiskimin e mjeteve të lojërave, magazinimin, si dhe shkatërrimin e tyre, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj;
- ç) heqjen e lejes për ushtrim aktiviteti ose propozimin për heqjen e lejes/licencës së ushtrimit të aktivitetit organit që e ka lëshuar atë;
- d) sekuestrimin e pasurive të regjistruara në emër të subjektit.”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 29.4.2013

**Shpallur me dekretin nr. 8170, datë 13.5.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 8163, datë 10.5.2013**

**PËR EMËRIMIN E REKTORIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 92 shkronja “g” dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 23 pika 2 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

Zoti Vejsel Rizvanolli, emërohet rektor i Universitetit të Sporteve të Tiranës.





Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**VENDIM**  
**Nr. 399, datë 8.5.2013**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1210, DATË 11.12.2009 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË  
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË  
PËRDORIM TË KOMUNËS KUMAN TË QARKUT TË FIERIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1210, datë 11.12.2009, të Këshillit të Ministrave, shtohen pronat me nr. 123-152 (njëqind e njëzet e tre deri njëqind e pesëdhjetë e dy), gjithsej 4 (katër) fletë, sipas lidhjes nr. 1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi e janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kuman për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

Komuna Kuman

Lidhje 1

<b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>	<b>Numri i ngastres që transferohet sipas listes se inventarit</b>	<b>Fusha e përdorimit të pronës</b>	<b>Lloji i transferimit</b>
123,	128,230/2,230/4,230/5, 229,231,277, 239,418,426,320/10,	Toke pafrut dhe Kanale te treta	Ne pronesi
124	230/12,261,259, 254,253,399,400, 401.	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
128	421,420	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi
134	335,356,354	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
135	98/2, 350,351,352,353.	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi
136	347,348,349	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
137	414,415	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi
138	417,416.	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
139	406	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi
140	228/3	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
141	405,407,408	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi
143	365	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
144	346,345	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi
145	148/4,369,370,372	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
147	363	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi
149	367,368	Rruge e kanale te treta	Ne pronesi
127	424	Toke pafrut dhe treta	Ne pronesi

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Hyri në shtyp më 15.5.2013  
Doli nga shtypi më 15.5.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 25 lekë